

NEWSLETTER

Shtator

**Albsig Fushatë të Dedikuar
për Shkollat në Kuadër
të Sigurimeve të Nxënësve
dhe Studentëve**

**Albsig Ofron
Sigurimin Kids/Youth,
Mundësi dhe Paketa të Dedikuara
për Fëmijët dhe të Rinjtë
për një Jetë më të Sigurt
dhe të Shëndetshme**



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP

**Albsig, Shoqëria
që Edukon të Rinjtë
për Rëndësinë e Sigurimeve**

**Zotëroni
Kartën e Studentit,
Përfitoni 40% Ulje
për Sigurime të Ndryshme**

**Albsig ju Dëmshpërblen
në Kohë Rekord,
Bazuar kjo në Praktika
dhe Dëshmi Reale.
Dëshmia e Artan Xhihani
Pronar i Hotel Ujvara**

**Sigurimi nga Aksidentet i Nxënësve dhe Studentëve
Apeli i Albsig: Mbroni Familjen Tuaj
nga Faturat e Papritura Mjekësore.**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP

Sigurimi nga Aksidentet i Nxënësve dhe Studentëve.



Apeli i Albsig: Mbroni Familjen Tuaj nga Faturat e Papritura Mjekësore.

Sigurimi i nxënësve dhe studentëve është "arma" e parë me të cilën ato pajisen për të pasur më të sigurtë vitin shkollor. Një student në Europë paguan mesatarisht 45 €/muaj për Sigurimin e Shëndetit. Në Shqipëri, nxënësit dhe studentët janë fare të ekspozuar nga aksidentet. Edhe pse pandemia bëri paksa edukim mbi shëndetin, duket se një pjesë shumë e vogël e prindërvë janë ndërgjegjësuar për sigurimin e nxënësve dhe studentëve. "Kam djalin në shkollën e Hoteleri Turizmi, dhe në fillim, në vitin e parë ia kërkoi shkolla si me detyrim sepse ne nuk ishim mësuar me këtë pjesë, por më pas sigurimi u bë pjesë e vitit të ri shkollor. "Eshtë viti i tretë që unë djalin e siguroj në Albsig", tregon Gentjana Mahmutaj, prind i njërit prej nxënësve të siguruar në Albsig. Kjo e fundit apelon që të gjithë nxënësit të bëjnë sigurimin nga aksidentet pasi një investim i vogël sot mbron shumë nesër. Në dyert e shkollës së Hoteleri Turizmit takon shumë prindër, të cilët e dinë mirë rëndësinë e sigurimit të fëmijëve tyre. Madje një pjesë e tyre, teksa i pyesim na e tregojnë direkt në dorë sigurimin e fëmijëve. Ekspertët e sigurimeve i shikon të pozicionuar pran stendave të pothuajse të gjitha kompanive që janë në treg. Aktualisht fillimi i vitit akademik është dhe fillimi i nismës që ndërmerr tregu për edukimin e nxënësve mbi sigurimet. "Shkollat profesionale janë dhe shkollat që pajisen çdo vit me sigurimin nga aksidentet. Bëjmë thirrje çdo prindi që të bëjë të mundur sigurimin e fëmijëve, qoftë nxënës apo student", apelon ekspertja e sigurimeve nga shoqëria e Sigurimeve Albsig.

Çfarë është Sigurimi nga Aksidentet i Nxënësve dhe Studentëve?

Me rritjen e kostove të kujdesit mjekësor dhe mundësinë e lartë të sëmundjeve të papritura, sigurimi i cilësisë së shëndetit tuaj nuk është diçka që mund të anashkalohet, por një faktor shumë i domosdoshëm për t'u marrë parasysh. Pavarësisht nëse jeni në vitet e para të shkollimit, apo do të filloni universitetin, ekzistojnë plane sigurimi për nxënës dhe studentë. Kjo policë; jo vetëm që do t'ju mbajë të shëndetshëm në ambjentet e shkollës dhe do t'ju ndihmojë të kurseni para, por shumica e kolegjeve dhe universiteteve jashtë vendit kërkojnë dëshmi të sigurimit shëndetësor të studentëve.

ÇFARË PËRFSHIN?

- Shpenzimet e trajtimit mjekësor në të gjitha entet shëndetësore
- Shpenzimet për medikamentet mjekësore
- Paaftësinë e perhershme të plotë ose të pjesshme
- Vdekjen ose zhdukjen e shkaktuar nga aksidenti, etj.

DËMET E MBULUARA

- Helmimi akut
- Mbytja
- Ngrirja
- Goditja dhe djegia nga rrezet e diellit
- Dëmtime të shkaktuara nga sforcime fizike
- Asfiksia, etj.

Qëllimi i kësaj kontrate është mbrojtja e shëndetit dhe jetës së fëmijëve dhe të rinjve që janë në periudhën e shkollimit. Sigurimi i nxënësve dhe studentëve është sigurim 1-vjeçar me një prim simbolik prej 500 lekë për nxënësit me shumë sigurimi 200,000 lekë. Ky sigurim përfshin mbulimet për:

- Përfitimi për frakturat, e cila jepet me një shumë të menjëherëshme kur si shkak i një aksidenti ndodh thyerja e eshtrave të gjymtyrëve të sipërm ose të poshtëm.
- Përfitimet për paaftësinë e përhershme ose të pjesshme.
- Shpenzimet spitalore dhe farmaceutike.
- Përfitimi për sëmundjet kritike.
- Në rast të humbjes së jetës së prindit, i siguruari përfiton shumën e sigurimit.
- Përfitimi për humbjen e Jetës së të Siguararit.

Albsig Fushatë të Dedikuar për Shkollat në Kuadër të Sigurimit të Nxënësve dhe Studentëve

Me fillimin e shkollës kanë nisur dhe ofertat e paketave të sigurimeve të nxënësve dhe studentëve në të gjithë tregun e sigurimeve, ku në Albsig duket se janë më të kërkuarat. Shoqëritë e sigurimeve ofrojnë paketa specifike me çmime simbolike për sigurimin e nxënësve dhe studentëve, duke tentuar t'ia heqin prindërve "barrën" e kostove shëndetësore, dhe duke u lënë vetëm atë të arsimimit. Por megjithatë, janë prindërit ata që nuk mendojnë mjaftueshëm në këtë drejtim, për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Është viti i pestë që Albsig starton fushatën për sigurimin e nxënësve nëpër shkollat e të gjithë vendit, ku kërkesën më të madhe e mban qyteti i Tiranës, duke pasur numrin më të madh të shkollave profesionale. Konkreisht, Albsig sh.a ofron sigurimin e nxënësve për një periudhë 1 vjeçare për nxënësit, në një vlerë mesatare simbolike prej 500 lekësh. Kontrata e sigurimit është hartuar e dizenuar me synimin që të ofrojë për prindërit një mbështetje financiare në rast sëmundje apo aksidenti të fëmijës, gjithashtu dhe për të krijuar një kulturë sigurimesh tek brezi i ri. Ndërkaq, Albsig ka ngritur grupin e punës për të menaxhuar në disa shkolla situatën e nxënësve. Çdo shkollë është e pajisur me standat përkatëse ku çdo nxënës merr udhëzimet dhe në fund pajiset me sigurimin e kërkuar.

**VETËM
500**
lekë/vit

Fushata në Emër të Nxënësve

"Është viti i pestë që të gjitha shoqëritë e sigurimeve janë sensibilizuar për të krijuar sadopak një kulturë mbi rëndësinë e sigurimeve. Kjo duket tek ndërgjegjja e të rinjve që sa vjen e shtohet kundrejt fenomenit për t'u siguruar. Një pjesë e profesioneve e kanë të domosdoshme të jenë të mbrojtur për gjatë gjithë vitit akademik."

-Kështu nis të tregoj mësuese Mira Gjoka.


**BACK To
School**

Mësuesja tregon se vështirësia për të bindur haset më shumë tek vitet e para pasi këta të fundit nuk janë të pajisur me këtë lloj sigurimi. Njëkohësisht jo vetëm kaq, por një pjesë e mirë e nxënësve janë ndikuar nga përvojat e bashkëmoshatarëve të tyre dhe tani janë të njohur me rëndësinë e të pajisurit me një kontratë sigurimi.

“Ne bëjmë sqarimin e rëndësisë së kontratave të sigurimit për secilën klasë apo për secilin nxënës, janë nxënësit ata, që paraqiten pranë stendave të shoqërive të sigurimeve dhe bëjnë konkrete blerjen e siguracionit. Aktualisht janë të gjitha shoqëritë e sigurimeve prezente, por ajo që është më dominuese në shkollën tonë është Albsig. Staf i tyre i sqaron me përpikmëri çdo nxënës që shkon pranë stendave të tyre dhe më pas i pajis ato me siguracionet e kërkuara”, tregon mësuese Gjoka.

Albsig, Shoqëria që Edukon të Rinjtë për Rëndësinë e Sigurimeve

Një staf i dedikuar për sigurimin e nxënësve dhe studentëve është ngritur pranë shoqërisë së sigurimeve Albsig. Fillimviti është periudha e paracaktuar prej më shumë se pesë vitesh që i është dedikuar vetëm nxënësve e sidomos shkollave profesionale. “Edukimi i të rinjve mbi sigurimet, rëndësia e sigurimeve dhe ndikimi i tyre në financat e familjeve shqiptare”, kjo ka qenë tema që është trajtuar në të gjitha shkollat, jo vetëm në kryeqytet por edhe nëpër rrethe, aty ku janë më të përqëndruara shkollat profesionale dhe jo vetëm. Sipas specialistëve të Albsig vetëm nxënësit e viteve të para kanë vështirësi në fillim, por edhe ato duke ua sygjeruar mësuesit rëndësinë e pajisjes me kontratën e sigurimeve arrijnë të binden për ta realizuar atë. Është një çmim i përballueshëm sepse mund të përballohet nga çdo familje shqiptare. Jo vetëm kaq, por ekspertët e sigurimeve në Albsig shtojnë se kontrata e sigurimeve të nxënësve është hartuar e dezenjuar në mënyrë të tillë për t’i ardhur në ndihmë të gjithë target grupeve të popullsisë.





Albsig Ofron Sigurimin Kids/Youth, Mundësi dhe Paketa të Dedikuara për Fëmijët dhe të Rinjtë për një Jetë më të Sigurt dhe të Shëndetshme

Albsig ka në fokus sigurimin e fëmijëve dhe të rinjve. Edukimi i gjeneratave të reja mbi sigurimet ka qenë dhe do të jetë në fokus kryesor të Albsig. Shkolla tashmë ka filluar dhe bashkë më të vijnë edhe të papriturat. Për të siguruar edhe të papriturat që mund të ndodhin gjatë shkollës dhe jo vetëm, Albsig mendon për ju. Për të gjithë fëmijët/të miturit në moshën 0-15 vjeç, të cilët frekuentojnë ciklin e arsimit para-universitar, ose të ashtuquajturin arsim të detyrueshëm dhe të rinjtë në moshën 15-25 vjeç, të cilët kryejnë studimet universitare, pasuniversitare ose fakultetin e dytë, ofrohet Polica e Sigurimit "Kids/Youth". Nëpërmjet kësaj police mbulohen shpenzimet për aksidente që ndodhin për shkaqe rastësore, të dhunshme, të menjëherëshme dhe të paparashikuara, ku si pasojë e së cilave mund të vërtetohet paaftësia e përkohshme, e përhershme dhe/ose humbja e jetës.

Duke kryer Policën e Sigurimit të "Kids/Youth" mbulohen shpenzimet si pasojë e aksidenteve përgjatë periudhës së mbulimit të përcaktuar në kontratë dhe nëse fëmijët apo të rinjtë e siguruar janë brenda territorit të Shqipërisë. Shpenzimet që njihen kanë aftësi diagnostikuese, stabilizuese apo përmirësuese, të cilat janë të nevojshme nga ana mjekësore. Për fëmijët/të rinjtë ofrohet mbulimi i shpenzimeve të trajtimit mjekësor në të gjitha entet shëndetësore për dëmtime që vijnë si pasojë e aksidentit, paaftësinë e përhershme të plotë ose të pjesshme sipas kushteve të sigurimit; vdekjen ose zhdukjen e shkaktuar nga aksidenti. Ndërsa për prindin/kujdestarin ligjor ofrohet mbulimi për paaftësinë e përkohshme sipas kushteve të sigurimit dhe vdekjen ose zhdukjen e shkaktuar nga aksidenti kundrejt pagimit të primit të përcaktuar në Policën e Sigurimit.

Zotëroni

Kartën e Studentit?

PËRFITONI

deri në
40% ULJE
për sigurimet e ndryshme



Karta e Studentit është mjeti nëpërmjet të cilit studentët përfitojnë mjaft avantazhe, tarifa të reduktuara dhe oferta të dedikuara, si nga institucionet publike ashtu edhe nga subjektet private. Paisja dhe paraqitja e kartës është e detyrueshme nga ana e çdo studenti për përfitimin e këtyre avantazheve. Në rrjetin e shërbimeve publike, me të cilin mund të njiheni duke klikuar mbi ikonën "Shërbime Publike", paraqitja e kartës është e mjaftueshme. Këto pikë të grumbulluara, studenti kartëmbajtës mund t'i përdorë si vlerë monetare për të realizuar çdo lloj blerje në të gjithë rrjetin e këtyre subjekteve private, të cilët i janë bashkuar nismës së Bashkisë Tiranë. Në rrjetin e shërbimeve private partnere, me të cilin mund të njiheni duke klikuar mbi ikonën "Shërbime Private", studentët përfitojnë uljet dhe ofertat e dedikuara për ta, në formë pikësh të ngarkuara në kartë nëpërmjet leximit të saj nga sistemi (jo thjesht paraqitjes së kartës) që përdor secili prej aktiviteteve private. Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, gjithmonë ka treguar angazhimin e saj në fushën e përgjegjësisë sociale. Karta e Studentit është një mjet që ofron shumë avantazhe për studentët, duke përfshirë tarifa të reduktuara dhe oferta të posaçme, nga institucionet publike dhe bizneset private. "Të gjithë studentët që e kanë Kartën e Studentit mund të përfitojnë produktet e Albsig me një zbritje të ndjeshme në çmim. Nëse keni Kartën e Studentit, na vizitoni dhe zbuloni ofertat speciale, të dedikuara vetëm për ju" thuhet në Njoftimin për shtyp publikuar nga Albsig. Tashmë studentët do të kenë mundësi të marrin produkte sigurimi jo vetëm për vete por edhe për familjen e tyre me 40% ulje nga çmimi ekzistues.



ALBSIG



**PJESË E
KASTRATI GROUP**



Albsig ju Dëmshpërblen në Kohë Rekord, Bazuar kjo në Praktika dhe Dëshmi Reale

Dëshmia e Artan Xhiani Pronar i Hotel Ujvara: Të gjitha Përvojat e Dëmeve në Albsig janë në Kohë Rekord, Kundrejt Procedurave të Rregullta në Favor të Klientit.

Çfarë e bën Albsig të jetë zgjidhja më e mirë për këdo?

Sigurisht, shpejtësia dhe korrektësia në dëmshpërblime. Kjo është e faktuar nga vetë shqiptarët, pasi duket se Albsig është zgjedhja e tyre e parë. Jo vetëm kaq, Albsig mban dhe rekordin në shpejtësinë e dëmshpërblimit, duke e bërë kështu lider edhe në industrinë e sigurimeve. Kur vjen fjala për dëmshpërblimet, duket se shqiptarët janë shumë të ndjeshëm dhe tashmë kanë ditur ku ta besojnë sigurimin e biznesit, investimin e një jete.

Hotel Ujvara, është një ndër bizneset që është siguruar në Albsig. Pronari i Hotel Ujvarës z. Artan Xhiani në një rrëfim të singertë tregon me shumë detaje lidhjen e tij me Albsig, dhe rëndësinë që ka sigurimi i një biznesi. Historiku i dëmeve me Albsig për z. Xhiani ka filluar që në kohën e tërmetit, deri para një muaji që është mbyllur me përvojën e fundit. Ai thekson se Albsig-un e ka përzgjedhur me vullnet të plotë, i pa influencuar nga njeri, por vetëm i bindur nga shembulli që kjo e fundit ka dhënë në punën dhe mbështetjen ndaj klientëve në rast dëmi.

“Përvoja e parë e dëmshpërblimeve me Albsig ka nisur me tërmetin e vitit 2019. Ajo ishte përvoja e parë e cila u nis dhe u mbyll me shumë sukses kundrejt të dy palëve. Isha tejet i befasuar me suportin që më ka dhënë kjo kompani. Edhe pse pash në sytë e shumë pronarëve të bizneseve frikë dhe dështim, në sytë e mi kjo ndjesi nuk ekzistonte. Të kesh suport një kompani si Albsig, biznesi është edhe më i sigurt.”

Kështu nis të tregoj përvojën e tij të parë me dëmet në Albsig z. Xihani. Jo vetëm kaq por ai ka fragmentizuar çdo detaj në komunikimet që ka pasur me grupin e ekspertëve të departamentit të dëmeve në Albsig. Dhe nuk le pa i vlerësuar edhe këto të fundit.

“Kur ishte tërmeti grupi i punës nga Tirana më kanë marr në telefon, më kanë njoftuar dhe kanë nisur ekspertimin e ngjarjes, derisa kanë bërë gati dosjen dhe më pas kemi rënë dakord për shumën e dëmit”, –tregon detaje nga ngjarja.

Njëkohësisht ai shton se përveç biznesit, ka siguruar dhe automjetet dhe personat e familjes. Si në rastin e dëmtimeve të pësura nga tërmeti, ashtu edhe pas incidentit të ndodhur për shkak të shiut të para pak ditëve, Albsig ka bërë menjëherë vlerësimet tek Hotel Ujvara dhe e ka dëmshpërblyer biznesin brenda një kohe shumë të shkurtër.

“Përvoja e fundit e Albsig ishte para pak ditësh që kisha probleme me ujrat nga shiu. Menjëherë pas ndodhjes së dëmit kemi njoftuar ekspertët e sigurimit, të cilët kanë ardhur në vendin e ngjarjes menjëherë. Dëmi është vlerësuar dhe dosja është kaluar në kohë rekord dhe kundrejt çdo rregulli e korrektësie”, –tregon Xihani.

Ai i bën apel çdo sipërmarrësi që të bëjnë të mundur sigurimin e biznesit nga zjarri dhe rreziqet shtesë.

“Me sigurimin e biznesit, nuk sigurojmë vetëm jetën tonë por dhe jetën e fëmijëve tanë”, –përfundon apelin e tij sipërmarrësi.

 **albsig.al**

**Ndiqui intervistën
e plotë këtu**





☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL